



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
Departamenti Procedurave dhe Teknologjisë së Informacionit  
*Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit*

Nr. 9300 Prot.

Tiranë, më 22/8 /2014

**Lënda:** Procedurat dhe dokumentacionin që do të mbajnë sektorë të veçantë të biznesit

**Drejtuar:** Drejtorisë Rajonale Tatimore \_\_\_\_\_

Mbështetur në V.K.M Nr 781, datë 14.11.2007, e ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr 16, datë 03.05.2010, pika 19, për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që do të mbajnë sektorë të veçantë të biznesit për përdorimin e pajisjeve fiskale duke marrë parasysh specifikat që përfaqësojnë këta sektorë.

**URDHËROJ**

1. Te ngrihet sistemi i raportimit online për shoqëritë e tregtimit të hidrokarbureve me shumicë.
2. Te krijohet infrastruktura e nevojshme për të deklaruar dhe ruajtur në sistem sasitë e produkteve të importuara.
3. Për çdo shoqëri në të cilat nuk mund të instalohet sistemi fiskal të krijohen llogaritë në këtë sistem të siguruar me <emër përdoruesi>, <fjalë sekrete> dhe firme elektronike.
4. Te gjitha shoqëritë e importit të hidrokarbureve, të cilat sjellin produkte nga dogana tokësore duhet të kryejnë procedurën e deklarimit në serverin online si dhe pajisen me një dokument zëvendësues të kuponit tatimor.
5. Dokumenti Zëvendësues i Kuponit Tatimor duhet të ketë pjesë përberse të tijen serialin e gjeneruar nga sistemi si dhe element të tjerë sigurie të gjeneruar nga sistemi i deklarimit të pajisjeve fiskale.
6. Te publikohet në faqe të internetit kjo procedurë si dhe shembull i Dokumentit Zëvendësues të Kuponit Tatimor

Shoqëritë e tregtimit të hidrokarbureve me shumicë të cilët janë të detyruar të shoqërojnë mallin me faturë dhe kupon tatimor, nga importi, duhet të deklarojnë volume, vlerat si dhe destinacionin e produktit që po importojnë sikurse me pajisje fiskale.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GAZMIR SPAHILJA**